

Burimet: SMIP, *Teroristički...*, III, 934; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 46; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998.godini*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

Rexhë (Sadik) Qorraj

(27.02.1961, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, jurist, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Arton (Nezir) Qorraj

(13.10.1980, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Rexha dhe Artoni kanë qenë djemtë e axhës. Rexha i ishte bashkangjitur UÇK-së më 20.04.1998. Artoni ishte në klasën e tretë të shkollës së mesme kur u bë ushtar i UÇK-së. Rexha ka qenë i ngarkuar me logjistikë në njësitin e tij. Që të dy kanë rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua më 13.07.1998, në afërsi të shtëpisë së Ibër Demhasajt në Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg. Një ditë më vonë, familjarët i kanë varrosur Rexhën dhe Artonin në një fushë të fshatit. Në nëntorin e vitit 2000, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glllogjan/Glodane.

Burimet: deklarata A.Q, FDH-29224; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; deklarata S.D, FDH-12203.

Isuf (Hysen) Imeraj

(27.02.1931, shqiptar nga Isniqi/Istiniç, komuna e Deçanit/Deçani, mësues, pesë fëmijë)

Isufi ishte mësues përpara se të shkonte në pension. Në shtëpinë e tij ishin të vendosur njerëz që e mbronin fshatin. Diku nga ora 18:00 të datës 13.07.1998, forcat serbe filluan me granatimet nga drejtimi i rrugës magjistrale Pejë/Peć - Deçan/Deçane. Nga ora 20:30, Isufi me familje e kanë braktisur shtëpinë. Ata e shoqëruan grupin e fshatarëve që ishin strehuar tek ambulanca [Isniq/Istiniç]. Por, predhat filluan së shpejti të binin edhe mbi atë vend. Një predhë ka eksploduar afër Jusufit dhe e ka

plagosur rëndë. E çuan në ambulancë, ndërkaq më vonë pjesëtarë të UÇK-së e dërguan në spitalin e Irzniqit/Rzniç. Në rrugë e sipër drejt Irzniqit/Rzniç, ai dha shpirt. U varros në varrezat e fshatit një ditë më vonë, më 14.07.1998,

Burimi: deklarata A.I, FDH-17063.

Enver (Hasan) Avdimetaj

(10.01.1969, shqiptar nga Strellci i Epërm/Gornji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani, tekniku i veterinarisë, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Enveri i ishte bashkangjitur UÇK-së më 25.04.1998 dhe menjëherë u emërua komandant shtabi në Strellcin e Epërm/Gornji Streoc. Ishte përgjegjës për sigurimin e transportit të armatimeve nga Shqipëria. Enveri ka rënë në Strellcin e Epërm/Gornji Streoc, gjatë betejës me forcat serbe që u zhvillua më 14.07.1998.

Burimet: J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Miftar (Ali) Bajraktari

(1.12.1952, shqiptar nga Isniqi/Istiniç, komuna e Deçanit/Deçani, tetë fëmijë, civil i armatosur)

Miftari u inkuadrua në mbrojtjen e fshatit në verë të vitit 1998. Për detyrë e kishte vëzhgimin e terrenit nga pozicioni *Balaj/Balaj*, çdo ditë nga ora 17:00 deri në orën 7:00 të mëngjesit. Në datën 15.07.1998, nga ora 19.00, përderisa ishte në detyrë [Isniq/Istiniç], Miftari ka gjetur vdekjen nga eksplodimi i një predhe. Pjesëtarë të UÇK-së e kanë çuar atë gjatë natës në xhaminë e fshatit, ndërkaq në mëngjes e kanë njoftuar familjen. Një ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur Miftarin në varrezat lokale.

Burimet: deklarata S.B, FDH-17061; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Ivan (Petar) Marković

(27.09.1978, kroat nga Subotica, tekniku mekanik, pjesëtar i UJ-së)

Ivani ishte punësuar si axhustator në fabrikën *Hemos* në Suboticë. Në datën 15.03.1998, ka